

INSPEKTORATI SHETËTOR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI PRILL 2026						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	01.04.2026	<p>Në kuadër të shqyrtimit të disa ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, është shfaqur nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në këto ankesa.</p> <p>Për këtë arsye ju drejtohem Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për të kërkuar informacion ne lidhje me tarifat e analizimit te këtyre komponentëve:1- pH;,2- Gramaturë;, 3- Volumi specifik dhe densitet;, 4- Trashësi;,5- Opecitet;,6- Lagështi;,7- Përmasat.</p> <p>Ne përgjigje te shkresës se më sipërcituar, institucioni juaj I. S.H.T.Industrial informon institucionin tonë, se Laboratori i Tekstileve kryen këto testime për letër dhe karton:</p> <p>1- Gramaturë;,2- pH;,3- Trashësi;,4- Volumi specifik;, 5- Densitet;,6- Opecitet;,7- Lagështi;,8- Përmasat.</p> <p>Te gjithë treguesit e sipërcituar janë te akredituar nga Drejtoria Pergjithshme e Akreditimit DPA. Kostot për testimet e një kampioni letër/karton, ku përfshihen treguesit e sipërcituar është 9000 (nëntëmijë) leke.</p> <p>Për sa më sipër jeni të lutur të na dërgoni tarifën për secilin tregues më vete si dhe numrin tuaj të llogarisë, ku do të kryhet pagesa për shërbimin e testimit.</p>	01.04.2026	<p>Laboratori i Tekstitit pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe industrial, nuk tarifton për cdo tregues por për cdo kampion ku përfshihen të gjithë treguesit e cituar siç dhe jua kemi përcjellë në shkresën nr . 2835/1 prot, date 24.03.2026. Kjo tarifë është 9000 (nëntëmijë) leke per kampion.</p> <p>Procedura që ndiqen për të kryer analiza është si më poshtë:</p> <p>Paraqitet subjekti pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me një kërkesë shoqëruese për kampionet për analizim</p> <p>Subjektit I jepet kopja e kërkesës me nr. Protokollit dhe fatura më të dhënat bankare ku subjekti shkon dhe kryen pagesën në bankë dhe sjell një kopje të mandatit në zyrën e protokollit.</p> <p>Me marrjen e mandat pagesës, kampionet dërgohen në laborator për testim.</p> <p>Kohezgjatja e procesit është 5 dite pune</p> <p>Njoftohet subjekti që raport analizat janë gati dhe vjen i merr dorazi ose i dërgohen me postë</p>	E plotë	0
2	07.04.2026	<p>Kërkesë për informacion lidhur me një projekt që ka të bëjë me certifikimin e një baterie litiumi që përdoret për printera.</p> <p>Sipas kësaj kërkesë, ata janë duke mbledhur informacion për të vlerësuar nëse ekzistojnë rregullore kombëtare për këtë lloj baterie, veçanërisht ato që lidhen me mjedisin, si siguria apo kërkesa të tjera që kanë të bëjnë me të.</p> <p>Gjithashtu, nëse marka CE njihet në këtë rast si një mënyrë për të dëshmuar përputhshmërinë/konformitetin e produktit. Në rast se institucioni juaj është përgjegjës dhe ka informacion lidhur me objektin e kërkesës, do ju luteshim të na dërgoni një përgjigje me informacionin e kërkuar brenda një kohe sa më të shpejtë të mundur.</p>	09.04.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës për informacion ardhur në info@ishti.gov.al mbi certifikimin e një baterie litiumi që përdoret për printer, ju bëjmë me dije se kjo kërkesë nuk përfshihet në detyrat ligjore të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial .</p> <p>Njëkohësisht, ju informojmë se nuk disponojmë informacion mbi organin kompetent pranë të cilit mund të drejtoheni për trajtimin e mëtejshëm të kësaj kërkesë.</p>	E plotë	0
3	13.04.2026	Sa sasi mostre duhet të sjellim për testet e detergjenteve?	14.04.2026	Sasia që duhet të sillni për analizim është minimumi 1 litër për kampion	E plotë	0
4	16.04.2026	<p>Jam nje banor një kompleksi,shkalla ime (nr.4) nuk u perfsihi nga zjarri dhe ndodhet jashte perimetrit te sigurise, pra une munda te aksesoj pa asnje problem ne apartament Dje ne darke u lidh enegjia elektrike dhe u ndezen pompat e ujit per 4 shkalle (1, 2, 3 dhe 7) nderkohe qe 3 shkallet e tjera (perfsihre timen) nuk u lidhen.</p> <p>Sot kontaktova me OSHEE mbi arsyet pse te shkalla 4 nuk u lidhen dritat dhe me thane qe duhet ti autorizojë ISHTI.</p> <p>Kuptoj qe shkalla e cila u perfsihi nga zjarri nuk mund te lidhet por nuk kuptoj arsyen se pse shkallet e paperfshira te mos lidhen perderisa nuk ka asnje evidence te ndonje problematike ne instalimet elektrike (apo hidraulike) te pallatit.</p> <p>Ju lutem te me informoni mbi hapat qe do ndiqni per rastin konkret dhe kur parashikoni te autorizoni OSHEE te lidhe linjen elektrike.</p>	17.04.2026	<p>Në vijim të kërkesës tuaj, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial sqaron sa më poshtë vijon ;</p> <p>Ngjarja e ndodhur me datë 14.04.2026, pranë kompleksit tuaj nuk konstatohet të jetë shkaktuar nga shkaqe elektrike.</p> <p>Ndërprerja e energjisë elektrike si masë urgjente për rrezik të mundshëm për njerëzit, vlerat materiale etj është kryer nga subjekti furnizues O.S.H.E.E për arsye sigurie i cili vendos për rikthimin e saj.</p>	E plotë	0

5	17.04.2026	<p>Në emër të banorëve të godinave 1 ,2, 3, 4, 6 dhe 7 të një kompleksi , ju përcjellim këtë ankesë lidhur me situatën e krijuar pas zjarrit të datës 14 Prill 2026.</p> <p>Ngjarja ka evidentuar mangësi serioze në kushtet e sigurisë së godinës, të cilat paraqesin rrezik për jetën, shëndetin dhe pronën e banorëve, si dhe kanë sjellë pasoja edhe në aspektin ekonomik.</p> <p>Kërkojmë verifikimin e situatës, vlerësimin e përputhshmërisë me standardet ligjore dhe identifikimin e përgjegjësive përkatëse, si dhe rekomandimin e masave për garantimin e sigurisë.</p>	17.04.2026	<p>Në përgjigje të e-mailit tuaj, Protokolluar në ISHTI me Nr. 3523 Prot datë 17.04.2026, në të cilin kërkohet vefikimi dhe garantimi I kushteve teknike, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Ngjarja e ndodhur me datë 14.04.2026 në pallatin tuaj , nuk konstatohet të jetë e shkaktuar nga shkaqe elektrike.</p> <p>Duke shprehur keqardhjen dhe duke qenë pjesë e shqetësimit tuaj në mbrojtje të interesit publik, sigurisë publike, sigurisë së njerëzve, të kafshëve shtëpiake, vlerave materiale në përputhje me pikat 2 dhe 4 të kërkesave tuaja në mënyrë të përmbledhur I.S.H.T.I sqaron se:</p> <p>Çdo instalim elektrik të ketë ;</p> <p>Projektin elektrik përkatës në përputhje me karakterin e objektit dhe karakteristikat e instalimit hartuar dhe nënshkruar nga një projektues i licensuar në fushën përkatëse. Deklaratën e konformitetit (instaluesit), e cila jep përgjegjësinë e instalimit elektrik. Çertifikatë inspektimi fillestar / periodik lëshuar nga O.M.V.K (Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit).</p> <p>Sistemin e tokëzimit në përputhje me kushtet teknike dhe normat në fuqi.</p> <p>Njëkohësisht furnizuesi me energji elektrike (të cilin keni kontraktuar) si përgjegjës për furnizimin me energji elektrike ka detyrimin që lidhja e energjisë elektrike të realizohet në përputhje me kushtet teknike dhe standardet në fuqi për pajisjet dhe instalimet elektrike para vënies së tyre në shfrytëzim, duke i kontrolluar ato në aspektin e sigurisë së jetës të njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga specialisti elektrik i caktuar posaçërisht nga subjekti furnizues me energji elektrike, rezultatet e kontrollit paraqiten me shkrim dhe ruhen nga të dyja palët.</p>	E plotë	0
---	------------	--	------------	---	---------	---